



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:070104

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441472

E.nr.663/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbartimit të kreditorit F.B. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson Av. Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër debitorit Universiteti i shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e shumës në emër të shujtës ushqimore dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 12/03/2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën E.nr.663/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.663/23, të datës 08/05/2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Aktgjykimit: 2020:070104, të datës 24.05.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 19/09/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 722.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.663/23, më datë 12.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi